

ANALIZË E BAZËS LIGJORE PËR KOMPENSIMIN E KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE

Maj 2024



ANALIZË E BAZËS LIGJORE PËR KOMPENSIMIN E KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE

Prof. Asst. Dr. Qerkin Berisha

Mbështetur nga:



SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy.

TABELA E PËRMBAJTJE

| | |
|----|--|
| 7 | 1. HYRJE |
| 8 | 2. ROLI DHE RËNDËSIA E KËSHILLAVE LOKALE |
| 10 | 3. BAZA LIGJORE PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLAVE LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS |
| 10 | 3.1 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale |
| 11 | 3.2 Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane |
| 14 | 3.3 Rregulloret komunale për bashkëpunimin e komunave me fshatrave me bashkësitë lokale |
| 15 | 4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR ADRESIM TË ÇËSHTJES |

1. HYRJE

Qëllimi kryesor i kësaj analize të shkurtër ligjore është shqyrtimi i kornizës ligjore që rregullon funksionimin e këshillave lokale, me fokus në bazën ligjore për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale. Është evidentuar si problem mospagesa e kryetarëve të këshillave lokale, e cila drejtpërdrejtë ndikon në mosfunksionimin e tyre dhe në pamundësinë e komunave që të realizojnë mandatin e tyre ligjor për bashkëpunim me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Prandaj, kjo analizë e shkurtër e kornizës ligjore ka për qëllim të identifikoj nëse ekzistojnë probleme ligjore dhe/ apo praktike në përmbushjen e detyrimeve të komunave për të kompensuar kryetarët e këshillave lokale, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Në vijim, analiza shqyrton rolin dhe rëndësinë e këshillave lokale në strukturën e vetëqeverisjes lokale. Baza ligjore për funksionimin e këtyre këshillave përfshin Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, si dhe rregulloret komunale për bashkëpunimin me bashkësitë lokale. Korniza ligjore e Republikës së Kosovës i trajton këshillat lokale si një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve komunale, duke mundësuar që ato të përfaqësojnë interesat e qytetarëve të zonave specifike brenda komunës dhe të sigurojnë që zëri i komunitetit të dëgjohej në vendimmarrje.

Fokusi i kësaj analize të shkurtër është vënë në çështjen e kompensimit të kryetarëve të këshillave lokale, duke analizuar rregulloret dhe praktikën aktuale në zbatimin e këtij legjislacioni. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2019¹ i Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) përcakton qartë kompensimin e kryetarëve të këshillave për pjesëmarrjen në takime, por komunat kanë interpretuar dhe zbatuar këto rregullore në mënyra të ndryshme. Për të rritur efikasitetin dhe transparencën e këtyre proceseve, është e nevojshme që fillimisht komunat të sigurojnë që kryetarët e këshillave lokale të jenë legjitim dhe të zgjedhur në një proces transparent, dhe pastaj të zbatojnë në mënyrë të duhur rregulloret e tyre komunale. Gjegjësisht, të zbatojnë në mënyrë të unifikuar dispozitat e legjislacionit në fuqi sa u përket çështjeve që lidhen me kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale për angazhimin e tyre dhe ofrimin e shërbimeve për komunën.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

2. ROLI DHE RËNDËSIA E KËSHILLAVE LOKALE

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe aktet nënligjore që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e këshillave lokale, këshillat lokale veprojnë si një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve komunale, duke përfaqësuar interesat e qytetarëve të zonave specifike brenda komunave. Këto këshilla do duhej të sigurojnë që zëri i komunitetit të dëgjohej dhe të merret në konsideratë në vendimmarrje, duke mbledhur dhe përcjellë shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve tek organet komunale. Kjo si rezultat ndikon në shtrirjen e demokracisë lokale, respektivisht, përmirësimin e praktikave demokratike dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Mbledhja dhe përcjellja e shqetësimeve apo kërkesave të qytetarëve tek organet komunale nxit transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë në qeverisjen lokale, të cilat janë parime kyçe të një shoqërie demokratike të fortë. Një angazhim i tillë jo vetëm që fuqizon qytetarët, por gjithashtu ndërton besimin në institucionet publike, duke forcuar kështu strukturën demokratike në nivel baze në komunitet.

Këto struktura si rregull janë të dizajnuara të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve përmes takimeve të rregullta dhe konsultimeve publike, duke fuqizuar qytetarët që të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë në diskutimet për politikën dhe vendimet që prekin jetën e tyre të përditshme. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve dhe politikave komunale, duke siguruar një standard të lartë të qeverisjes lokale dhe transparencës. Përfshirja e qytetarëve në procesin e konsultimeve publike për buxhetin dhe planifikimet e komunës, duke siguruar që vendimet financiare dhe zhvillimore të jenë të bazuara në nevojat dhe prioritetet e komunitetit është vetëm njëra nga fushat shumë të rëndësishme ku këto këshilla do të mund të luanin një rol esencial për komunitetin.

Prandaj, këshillat lokale luajnë një rol të rëndësishëm në bashkëpunimin me strukturat komunale për të adresuar dhe zgjidhur çështjet lokale, duke ndihmuar në koordinimin e veprimeve dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Përmes këtyre këshillave, komunat arrijnë të përmirësojnë komunikimin dhe konsultimin me qytetarët, duke e bërë më të shpejtë dhe më efikas shkëmbimin e informacionit për çështje të rëndësishme. Rrjedhimisht, të njëjtat duhet të shihen si një mekanizëm i komunave për të arritur objektivat e tyre në qeverisjen lokale. Këshillat lokale mund të kontribuojnë në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe social të zonave të tyre, duke mbështetur projektet komunitare dhe analizuar nevojat specifike të komunitetit për të marrë vendime të bazuara në informacion të saktë dhe të detajuar. Prandaj, këshillat lokale duhet të shihen si një mekanizëm që ndihmojnë komunën të arrijë qëllimet e saj dhe të përmirësojë cilësinë e qeverisjes dhe të shërbimeve publike.

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës ka rregulluar mirë çështjen e krijimit dhe rolit të këshillave lokale, megjithatë në praktikë ekzistojnë shumë sfida në funksionalizimin e këtyre këshillave. Ndër këto sfida, shumë nga këshillat lokale janë jofunksionale, rrjedhimisht të njëjtave në shumë raste mungon legjitimiteti, komunat nuk kompensojnë kryetarët e këshillave lokale për angazhimin e tyre dhe në shumicën e rasteve nuk kompensohen as shpenzimet që ata mund të kenë gjatë ushtrimit

të mandatit të tyre edhe pse kjo është e paraparë me aktet nënligjore në fuqi. Në shumë raste, ka munguar vullneti politik i komunave për të funksionalizuar këto këshilla, duke penguar kështu zhvillimin dhe efektivitetin e tyre. Ky konstatim ka dal edhe nga takimet që ka zhvilluar Platforma CiviKos me përfaqësues të komunave dhe ministrive përkatëse me qëllim të adresimit të sfidave në funksionalizimin e këshillave lokale.



3. BAZA LIGJORE PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLAVE LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Baza kryesore ligjore për rregullimin e themelimit dhe funksionimit të këshillave lokale bazohet në disa akte ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Në kuadër të kësaj baze ligjore përfshihen:

3.1 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale² përcakton parimet dhe strukturat bazë të vetëqeverisjes lokale. Ndër të tjera ky ligj rregullon edhe çështjen e bashkëpunimit të komunave me fshatrat dhe bashkësitë lokale, duke lënë hapësirë për Ministrinë përgjegjëse për Administrimin e Pushtetit Lokal që përmes akteve nënligjore të rregulloj më tej modalitetet e këtij bashkëpunimi, përfshirë krijimin dhe funksionimin e këshillave lokale.

Dispozitat e Nenit 34 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, kanë përcaktuar çështjet që ndërlidhen me bashkëpunimin në mes të komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Në vijim janë paraqitur dispozitat e nenit 34 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat theksojnë:

“Neni 34 Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane:

34.1 Çdo komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të komunës.

34.2 Me aprovimin e komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, vetë apo në mënyrë të kombinuar, mund të kryejnë aktivitete që bëjnë pjesë në përgjegjësitë dhe në kompetencat e komunës. Në këtë rast, komunat ofrojnë burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

34.3 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale lëshon udhëzime për marrëveshjet ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve.

34.4 Statuti dhe rregulloret lokale komunale e përcaktojnë formën e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe fushën e punës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane e respektojnë ligjin në fuqi gjatë kryerjes së aktiviteteve sipas marrëveshjes me komunën.”

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Bazuar në paragrafin 34.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale ka kompetencë për të nxjerrë udhëzime përkitazi me marrëveshjet në mes të komunave dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve. Bazuar në këto dispozita, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në vitin 2019³ u miratuar udhëzimi Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, i nënshkruar nga Ministria e MAPL-së me datë, 28.06.2019⁴. Në vijim janë trajtuar disa nga dispozitat e këtij udhëzimi, që janë të fokusuara në çështjet e trajtuara në këtë analizë.

3.2 Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane

Udhëzimi Administrativ (UA) specifikon mënyrat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale, si dhe bashkëpunimin e tyre me komunat. Në të njëjtën kohë, dispozitat e këtij udhëzimi në nenin 4, Paragrafi 1, krijojnë edhe bazë ligjore për vet komunat që të rregullojnë në mënyrë specifike çështjen e funksionimit të këshillave lokale, duke nxjerrë rregullore për të specifikuar në mënyrë të detajuar këto çështje. Në vijim janë trajtuar disa nga dispozitat e këtij udhëzimi që ndërlidhen me themelimin e këshillave dhe çështjet e kompensimit të kryetarëve të këshillave lokale.

Sa i përket rregullimit të këshillave, dhe procesit të zgjedhjes së tyre udhëzimi ka përcaktuar si në vijim:

- *Këshillat lokale – nënkupton trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.*
- *Kryetar/e i/e këshillit – nënkupton personin me të votuar në tubim zgjedhor në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.*
- *Neni 4, Paragrafi 1, ka përcaktuar se komuna përcakton me rregullore, mënyrën*
- *e funksionimit, formatin e takimeve dhe çështjet tjera të këshillave lokale.*
- *Neni 4, Paragrafi 2, ka përcaktuar se komuna themelon këshillat lokale në bazë të numrit të banorëve, duke përcaktuar maksimumin e këshillave për numër të banorëve.*
- *Kuvendi i Komunës themelon komision për të koordinuar procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.*

Nga dispozitat e mësipërme vërehet se këshillat lokale janë trupa që janë të zgjedhur nga komuniteti dhe përfaqësojnë komunitetin. Në procesin e zgjedhjes së këshillave lokale, komunat kanë një rol

3 Deri në vitin 2019 në fuqi ishte Udhëzim administrativ Nr. 2008/08 për marrëveshjet e bashkëpunimit të komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

4 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

të përcaktuar ligjor, i cili ushtrohet përmes komisionit themelohet nga Kuvendi Komunal dhe që ka mandat të koordinimit të procesit të zgjedhjes së këshillave lokale. Rrjedhimisht procesi i zgjedhjes së këshillave lokale është nën mbikëqyrjen e kuvendeve komunale. Ndonëse, këshillat lokale janë mekanizma që themelohen nën mbikëqyrjen e Kuvendit Komunal, i cili koordinon procesin e zgjedhjes së tyre dhe vendos rregulla për funksionimin e tyre, anëtarët e këshillave nuk janë të punësuar të komunës. Megjithatë, komunat mund të mbështesin financiarisht këshillat lokale, në veçanti kur ato kryejnë aktivitete që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.



Bashkëpunimi i komunës me këshilla lokale bëhet për çështjet që janë në kompetencë të komunës, duke përfshirë:

- *Planifikimin urban dhe rural;*
- *Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin;*
- *Shëndetësinë publike;*
- *Mbrojtjen lokale të ambientit;*
- *Turizmin;*
- *Hapësirave publike dhe varrezave;*
- *Aktiviteteteve kulturore dhe sportive etj.*

Ky bashkëpunim realizohet përmes një marrëveshje mes Komunës dhe këshillave lokale, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve. Ndonëse Udhëzimi përfshinë vetëm fushat e çështjeve, mënyra e realizimit të këtij bashkëpunimi mund të përfshijë aspekte të ndryshme, duke përfshirë edhe mobilizimin e komunitetit për të mundur arritjen e synimeve të Komunës në fushat me prioritet. Prandaj, këshillat lokale funksionale do të luanin një rol të rëndësishëm për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe funksional të komunitetit në fushat e planifikimit urban dhe rural, furnizimit me ujë, shëndetësisë publike, mbrojtjes së ambientit, turizmit, hapësirave publike, dhe aktiviteteteve kulturore dhe sportive. Në këtë proces, është e rëndësishme që pjesëmarrja dhe konsultimi i gjerë me të gjitha palët e interesuara të jenë fokus i secilës komunë.

Kompensimi i kryesuesve të këshillave lokale

Neni 12, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 ka paraparë kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale për pjesëmarrjen në më së shumti 6 takime brenda një viti. Dispozitat e nenit 12 - Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale theksojnë si në vijim:

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës përkatëse.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Nga dispozitat e mësipërme shihet se kryetarët e këshillave lokale kompensohen për takime. Rrjedhimisht, derisa nuk ka një marrëdhënie të rregullt pune me kryesuesit e këshillave lokale, të njëjtit nuk janë të punësuar të komunës. Për më tepër, derisa të njëjtit nuk janë përfshirë në Ligjin e Pagave në sektorin publik. Prandaj, kompensimi do të nënkuptoj një pagesë për shërbimet që ata ofrojnë për Komunën me rastin e organizimit të takimeve të cilat i realizojnë brenda një viti. Rrjedhimisht, komunat me rastin e finalizimit të procesit të përzgjedhjes së këshillave lokale, në vendimin e Kuvendit Komunal do të duhej të specifikojnë edhe çështjen e lartësisë së kompenzimit, kategorinë ekonomike nga do të bëhet kompenzimit duke specifikuar kategorinë e shërbimeve, dhe në të njëjtën kohë të buxhetojnë në procesin e rregullt buxhetor masë monetare për mbulimin e kostos së kompenzimit të kryesuesve të këshillave lokale.



3.3 Rregulloret komunale për bashkëpunimin e komunave me fshatrave me bashkësitë lokale

Rregulloret komunale për bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe organizimin e punës së këshillave lokale, përcaktojnë detajet e bashkëpunimit dhe organizimit të punës së këshillave lokale në nivelin komunal për secilën komunë. Këto rregullore janë të bazuara në udhëzimin e MAPL të trajtuar më sipër, i cili buron nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Në disa aspekte, në veçanti në rolin detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale, rregulloret komunale janë më të detajuara se sa udhëzimi administrativ i MAPL-së. Në kontekstin e qëllimit të kësaj analize të shkurtër janë analizuar rregulloret e komunave për bashkëpunimin me fshatrat dhe bashkësitë lokale nga një numër i konsiderueshëm i komunave. Disa nga komunat nuk kanë përditësuar rregulloret komunale pas ndryshimit të rregullores së MAPL-së, megjithatë, nga këndvështrimi i çështjes së diskutuar në analizë, kjo nuk paraqet ndonjë pengesë ligjore, për shkak se baza për kompensim është e përcaktuar në rregulloren e MAPL-së. Gjatë përgatitjes së kësaj analize të shkurtër janë analizuar dispozitat e disa prej rregulloreve të komunave Ferizaj⁵, Pejë⁶, Gjakovë⁷, Podujeva⁸, Prishtina⁹, Prizren¹⁰, Fushë Kosovë¹¹, Han i Elezit¹², Drenas¹³, Lipjan¹⁴, Malishevë¹⁵, Kamenicë¹⁶, Viti¹⁷ dhe Skenderaj¹⁸.

Këto rregullore përcaktojnë procesin e formimit të këshillave lokale, themelimin komisioneve nga kuvendet komunale, themelimin e këshillave lokale, mandatin e këshillave dhe ndërprerjen e mandatit, mënyrën konsultimit në mes të komunës dhe kryesuesit të këshillave lokale, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale, bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillat lokale si dhe çështjen kompensimit të kryesuesve të këshillave lokale.

Nga perspektiva ligjore, procesi i krijimit të këshillave lokale dhe funksionimit të tyre është i rregulluar. Sidoqoftë, nga diskutimet me përfaqësues të komunave është vërejtur se në shumë raste këto këshilla nuk janë funksionale. Për më tepër, pothuajse në të gjitha komunat nuk bëhet kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale siç kërkon rregullativa ligjore në fuqi. Nga punëtorja e organizuar nga Platforma CiviKosgjatë muajit maj 2024 me përfaqësues të komunave dhe të ministrive përkatëse për financa dhe për pushtet lokal, është konstatuar se moskompensimi i kryetarëve të këshillave lokale nuk është bërë për shkak se ka pasur dilema nëse të njëjtit duhet kompensuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, apo ndonjë kategori tjetër buxhetore. Po ashtu, u potencua që në shumë raste këto këshilla nuk janë legjitime për shkak se u ka kaluar mandati.

5 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35964>

6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29441&langid=1>

7 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11743&langid=1>

8 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61713&langid=1>

9 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16621>

10 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11951>

11 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11527>

12 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15271&langid=1>

13 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11866>

14 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73184&langid=1>

15 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11800&langid=1>

16 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15401>


17 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12145&langid=1>

18 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11904&langid=1>

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR ADRESIM TË ÇËSHTJES

Bazuar në Nenin 4, Par. 1 të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga MAPL, secila Komunë përcakton me rregullore, mënyrën e funksionimit, formatin e takimeve dhe çështjet tjera sa u përket këshillave lokale. Duke pas parasysh se ekzistojnë probleme në zbatimin në praktikë të këtij Udhëzimi administrativ, MAPL duhet të udhëzoj komunitat që të përgatisin rregullore të unifikuara që kanë të bëjnë me funksionimin e këshillave lokale, formatin e takimeve dhe çështjet tjera të ndërlidhura me zbatimin praktik të kërkesave të këtij udhëzimi.

Këshillat lokale janë përgjegjësi e Komunës, dhe është në interesin e Komunës që ato të funksionojnë me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të Komunës me fshatrat dhe bashkësitë lokale. Në këtë drejtim çështja e kompensimit të kryetarëve të këshillave lokale më shumë duket të jetë çështje e zbatimit të unifikuar në praktikë se sa një pengesë ligjore. Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 ka përcaktuar qartë që kryetarët e këshillave lokale kompensohen për më së shumti 6 takime brenda vitit. Përveç kësaj, ka përcaktuar edhe shumën e kompensimit, e cila është ekuivalente me shumën e kompensimit të anëtarëve të Komiteteve Obligative.



Në asnjë dispozitë, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 nuk ka përcaktuar nga cila kategori do paguhen kryetarët e këshillave lokale, por është përcaktuar qartë se kompensimit do të bëhet për takim dhe jo me një pagë, duke pas parasysh se anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale nuk konsiderohen të punësuar. Prandaj, komunitat nuk kanë asnjë pengesë që të bëjnë pagesën e kryetarëve të këshillave, duke e bazuar në evidencën e takimeve të mbajtura dhe rregulloret komunale për formatin dhe funksionimin e këshillave lokale. Kryetarët e këshillave Lokale duhet të organizojnë takimet sipas kërkesave të rregulloreve komunale dhe të mbajnë evidencë të atyre takimeve.

Kompensimi konsiderojmë se mund të bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, duke pasur parasysh natyrën e këtyre kompensimeve dhe faktin që kryetarët e këshillave lokale nuk janë të punësuar të komunës. Me rastin e nxjerrjes së vendimit nga Kuvendi Komunal për caktimin e kryetarëve të këshillave lokale, në vendim duhet të ceket edhe shuma e kompensimit dhe kategoria ekonomike nga e cila do të kompensohen. Ky qëndrim është mbështetur edhe në punëtorinë e zhvilluar nga Platforma CiviKosme pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunave dhe ministrive përkatëse për financa dhe për administrimin e pushtetit lokal. Për më tepër, egzistojnë shembuj në nivel qendror që anëtarët e jashtëm të komisioneve të ndryshme paguhen nga po kjo kategori e mallrave dhe shërbimeve dhe nuk ka pasur ndonjë gjetje nga raportet e auditimit.

Në rast të paqartësive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Trasfereve (MFPT) duhet të ofrojnë këshilla ligjore për implementimin në praktikë të këtyre akteve nënligjore. Nga punëtorja e organizuar nga Platforma CiviKos mund të vijmë në përfundim se komunat duhet të zgjedhin këshillat lokale në përputhje me kërkesat e rregulloreve komunale dhe të UA të MAPL-së, të bëjnë buxhetimin e rregullt në kuadër buxhetit komunal për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale.

Në përfundim, rekomandohet që pasi kjo analizë e bazës ligjore të dorëzohet te personat kompetent të ministrive përkatëse, këto të fundit të fillojnë procedurën e lëshimit të një qarkore të përbashkët që do të harmonizonte kërkesat legjislative të nivelit qendror me ato në nivel lokal, dhe sidomos të zbatimit të tyre të unifikuar në praktikë. Tutje, opsion tjetër për nivelin qendror drejt rregullimit të kësaj çështje mund të jetë edhe ndërhyrja në legjislacion, gjegjësisht në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së.

Në anën tjetër, kuvendet komunale do të duhej të përditësojnë rregulloret e tyre për funksionimin e këshillave lokale (nëse një gjë e tillë nuk është bërë tashmë), të planifikojnë buxhetin e duhur për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale sipas kërkesave ligjore dhe të lëshojnë vendimet për kompensimet e tyre.

